

FINCA Kosovë është Institucion Mikro Financiar, që operon në Euroazi, Lindje të Mesme, Afrikë dhe Amerikë Latine, shpallë:

FTESË PËR OFERTË

Institucioni Mikrofinanciar FINCA Kosovë, fton të gjitha Kompanitë e interesuara që të ofertojnë për Tenderin në vijim:

“Shërbime për mbajtjen dhe menaxhimin e arkivës në formë fizike dhe elektronike dhe asgjësimin e dokumentacionit” për nevoja të FINCA Kosovës me numër të prokurimit FINCA-106/26-1-Perseritje

Të interesuarit mund ta marrin specifikacionin për aplikim prej datës 27 Korrik 2026 në web faqe të FINCA Kosovës www.fincakosovo.org ne linkun <https://fincakosovo.org/tenders/>, ose përmes emailit zyrtar në: ks.procurement@fincakosovo.org.

Vërejtje:

- Malli dhe / ose shërbimet duhet të jenë me kualitet të lartë dhe me çmime të volitshme, TVSH-ja duhet të jetë e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë dy muaj (60 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen për njësi në Euro (€).
- Eksperienca e ofertuesit për punë të ngjashme (të bashkangjiten së paku tre referenca nga Institucionet me reputacion në Kosovë të cilat vërtetojnë se Ofertuesi ka kryer punë të ngjashme).
- Adresa e plotë dhe detajet për kontakt të Ofertuesit.
- Secila faqe duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga Drejtori i Kompanisë.
- FINCA Kosovë mban të drejtën për të bërë ndryshimin në specifikacion, të anulojë këtë Tender, të riftojë pjesëmarrësit individual për të riparaqitur ofertën e tyre, të diskualifikojë një ofertues pa dhënë njoftim apo arsye.
- Ofertat të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë dokument, mund të diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
- Asnjë shpenzim që bëhet gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të cmimit nuk do të kompenzohet nga FINCA Kosovë.
- Kriteret për përzgjedhje në këtë Tender bazohen në vendimin e Komisionit për Tender dhe të Bordit Menaxhues.

Oferta mund të dërgohet në formë fizike dhe në formë elektronike:

Oferta në formë fizike të dorëzohet në Zyrën Qendrore të FINCA Kosovës (Robert Doll Nr.112, 10000 Prishtinë).

- Oferta e dërguar në formë fizike duhet të jetë në zarf të mbyllur me pershkrim të qartë „për Departamentin e Administratës dhe me numer të Tenderit“.

Oferta në formë elektronike të dërgohet në email adresën zyrtare në

ks.procurement@fincakosovo.org

- Oferta e dërguar përmes postës elektronike duhet të jetë e mbrojtur me fjalëkalim.
- Fjalëkalimi duhet të dërgohet 48 orë pas mbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave (03 Gusht 2026).
- Ofertat e pambrojtura me fjalëkalim, do të shpallen të pavlefshme.

Oferta duhet të dorëzohet në dy pjesë të ndara: Oferta Teknike dhe Oferta Financiare.

Për informata shtesë ju lutemi kontaktoni përmes emailit në: ks.procurement@fincakosovo.org

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është e hënë, 03 gusht 2026 në orën 16:00.

